
JETA SHKENCORE

KRONIKË SHKENCORE: KONFERENCA SHKENCORE NDËRKOMBËTARE “PAVARËSIA E SHQIPËRISË DHE SFIDAT E SHTETIT SHQIPTAR GJATË SHEK. XX” Tiranë, 27 nëntor 2007

Në kuadrin e një sërë aktiviteteve të larmishme që u organizuan nga institucione të ndryshme me rastin e 95-vjetorit jubilar të shpalljes së pavarësisë së Shqipërisë, në datën 27 nëntor 2007 në hotel “Tirana International” u mbajt konferenca shkencore ndërkombëtare me titull **“Pavarësia e Shqipërisë dhe sfidat e shtetit shqiptar gjatë shek. XX”** nën kujdesin e kryeministrit prof. dr. Sali Berisha. Zhvillimi i këtij aktiviteti ishte rezultat i një bashkëpunimi të frytshëm midis Departamentit të Historisë së Shqipërisë, në Fakultetin e Historisë dhe të Filologjisë të Universitetit të Tiranës dhe Institutit të Historisë, Tiranë. Në këtë konferencë pati një pjesëmarrje të gjerë nga përfaqësues të enteve shtetërore, diplomatë të huaj, përfaqësues të klerit, studiues të ndryshëm të shkencave humane, gazetarë të medias së shkruar dhe asaj vizive, si edhe studentë të degës së historisë.

Në konferencë ishte i pranishëm edhe Ministri i Arsimit dhe i Shkencës z. Genc Pollo.

Studiuesit që ligjëruan në këtë konferencë ishin nga Shqipëria, Kosova, Mali i Zi, Maqedonia dhe Sllovenia.

Pasi moderatorja e seancës së hapjes prof. dr. Valentina Duka shënoi fillimin e veprimtarisë, prof. dr. Marenglen Verli, drejtor i Institutit të Historisë, Tiranë, mbajti fjalën e hapjes së punimeve të Konferencës. Në fjalën e tij ai theksoi se: “ne ende mahnitemi me pjekurinë dhe guximin e atyre burrave në ato situata të ndërlikuara, që ditën të përcaktonin momentin dhe aleatët e duhur për të hedhur themelet e shtetit modern shqiptar. Ne e ndjejmë përgjegjësinë që kemi para kombit, veçanërisht në këtë fundviti që afron ditën e madhe edhe për Kosovën e pavarur”. Më pas konferencën e përshëndetën z. Genc Pollo ministër i Arsimit dhe i Shkencës dhe prof. dr. Jusuf Bajraktari, drejtor i Institutit të Historisë, Prishtinë.

Ministri Pollo në përshëndetjen e tij, u shpreh se “një konferencë e tillë është momenti i duhur për të riparë edhe një herë historinë, tonë, si shtet, për të rigjykuar edhe një herë momentet, dinamikën, lëvizjet historike që e çuan në atë akt themelor për shtetin shqiptar, siç ishte Shpallja e Pavarësisë para 95 vjetëve, por edhe rrjedhat e tjera që ky akt përcaktoi, edhe zhvillimet e mëtejshme që ka njohur shteti shqiptar, herë pozitive dhe në drejtimin e duhur, por herë edhe me vështirësi e konfuzione”. Prof. Bajraktari, pohoi se: “kumtesat e autorëve do të paraqesin të arriturat e reja në studimet historike për këtë temë kurdoherë frymëzuese. Kontributet e kësaj konference e diskutimet parimore të çështjeve të rëndësishme do të zgjerojnë hullinë e njohurive për ngjarjet historike të lidhur me temën bosht”.

Seanca e parë u moderua nga prof. dr. Nevila Nika. Gjatë seancës së parë u mbajtën këto kumtesa: akademik Kristaq Prifti *Shpallja e Pavarësisë së Shqipërisë dhe çështja e një shteti të njësuar kombëtar*, prof. dr. Jusuf Bajraktari *28 Nëntori i 1912-ës, frymëzim për Kosovën shtet sovran dhe i pavarur*, prof. dr. Nevila Nika *Përgatitja dhe organizimi i kryengritjes së vitit 1912 në dokumentet shqiptare*, prof. dr. Muin Çami *Pavarësia e Shqipërisë midis të vërtetave historike dhe koniunkturave politike (1912-1920)*, prof. dr. Zekeria Cana *Rivrojtime të kryengritjes së Madhe të vitit 1912*, Sokol Gjermani *Qëndrimi i Austro-Hungarisë ndaj kryengritjes së vitit 1912*, prof. as.dr. Ilira (Çaushi) Sulo *Klerikët e harruar të Pavarësisë*, ma. Ledia Dushku *Ismail Qemali, Greqia dhe kryengritja shqiptare e vitit 1912*.

Gjatë seancës së dytë të moderuar nga akademik Kristaq Prifti kumtuuan studiuesit prof. dr. Marenglen Verli me temën: *Kufijtë e imponuar të shtetit shqiptar të pavarur, një konsensus ndërkombëtar me pasoj të rënda për shqiptarët*, prof. dr. Valentina Duka *Jehona tejtatlantike e Pavarësisë Shqiptare: në gjurmë të komenteve të shtypit amerikan (1912-1914)*, prof. dr. Ksenofon Krisafi *Çështja e kufijve të Shqipërisë në Konferencën e Ambasadorëve të Londrës (1912-1913)*, dr. Dritan Egro *Pavarësia e Shqipërisë, një moment i rëndësishëm në tranzicionin e elitës shqiptare*, prof. dr. Thoma Murzaku - Kozeta Sala *Politika e Austro-Hungarisë gjatë vitit të parë të pavarësisë së Shqipërisë*, prof. dr. Nail Draga *Rrethanat shoqërore dhe politike të shqiptarët në Mal të Zi në kohën e Shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë*, prof. dr. Kaliopi Naska *Roli i Këshillit Kombëtar në mbrojtje të Pavarësisë dhe tërësisë territoriale*, dr. Nebi Dervishi *Pjesëmarrja e*

delegatëve të Strugës dhe të Ohrit në Shpalljen e Pavarësisë së Shqipërisë.

Seanca e tretë u moderua nga prof. dr. Muharrem Dezhgiu. Të pranishmit dëgjuan në këtë seancë kumtesat e prof. dr. Beqir Metës *Qëndrimet e diplomacisë amerikane për Pavarësinë e Shqipërisë gjatë shekullit të kaluar*, të prof. dr. Gazmend Shpuzës *Pavarësia e Shqipërisë në vorbullën e ngjarjeve të viteve 1913-1915*, të prof. dr. Urosh Lipushçekut *Çështja kombëtare sllovene dhe shqiptare në kuadrin e Luftës së Parë Botërore - ngjashmëri dhe dallime*, të ma. Frashër Demajt *Roli i shtetit shqiptar në mbrojtjen e çështjes së Kosovës (1990-1999)*, të dr. Halim Purellkut *Pavarësia e Shqipërisë përballë aleancës serbo-slatiste (1919-1920)*, të prof. dr. Fehmi Rexhepit *Shteti shqiptar dhe Kosova (1912-1941)*, të ma. Enriketa Papas - ma. Gentiana Keras *Shkodra apo Tirana? Në kërkim të kryeqytetit të Shqipërisë së Pavarur*, të prof. dr. Fatmira Rama *Probleme të Pavarësisë dhe të konsolidimit të shtetit shqiptar në debati politik në emigracionin shqiptar (1925-1939)*.

Seanca e katërt u moderua nga prof. dr. Beqir Meta. Referuesit që u ligjëruan gjatë kësaj seance ishin: prof. dr. Muharrem Dezhgiu *Pavarësia e Shqipërisë përballë sfidave gjatë Luftës së Dytë Botërore*, prof. dr. Xhelal Gjeçovi *Çështja kombëtare shqiptare në vitet e Luftës së Dytë Botërore*, prof. as.dr. Hamit Kaba *Relacione të qeverisë komuniste me Demokracitë e Mëdha Perëndimore*, prof. dr. Sabile Basha *Pavarësia e Shqipërisë, pikë referimi për veprimtarinë ilegale në Kosovë (1945-1990)*, prof. dr. Ana Lalaj *Mjegulla për federatën dhe pavarësia e rrezikuar*, ma. Sonila Boçi *Shteti komunist dhe minoritetet në Shqipëri*, prof. as.dr. Ajet Shahu *Pavarësia në këndvështrimin e historiografisë shqiptare (1945-1990)*.

Në seancën e pestë të moderuar nga prof. dr. Valentina Duka pati diskutime për kumtesat e paraqitura në konferencë. Nga studiuesit e ndryshëm u bënë vlerësime, gjykime, kritika dhe interpretime në lidhje me temat, tezat, faktet, personazhet dhe ngjarjet që u trajtuan në kumtesat e mbajtura në konferencë. Prof. dr. Jusuf Bajraktari, në fjalën e mbylljes pohoi se: “konferenca rezultoi me sukses të plotë, si për numrin e kumtesave të prezantuara, ashtu edhe për argumentimin e çështjeve të trajtuara. Këtë radhë është shfaqur dhe ka dominuar dëshira, vullneti i mirë dhe i shumanshëm i ndërlidhjes së gjeneratave të ndryshme të studiuesve, në veçanti prezantimi i denjë i kolegëve të rinj, të cilët janë edhe ardhmëria e studimeve historiografike dhe albanologjike përgjithësisht”.

Sokol GJERMENI